

316.772.4

Xhemile SELMANI¹ MA

**NATYRA E PROCESIT TË GOJËTARISË JURIDIKE NË
SHOQËRINË BASHKËKOHORE**

**ПРИРОДАТА НА ПРОГРЕСОТ НА ПРАВНОТО
ГОВОРНИШТВО ВО СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО**

**THE NATURE OF THE ELOQUENCE LEGAL PROCESS IN
CONTEMPORARY SOCIETY**

Abstract

The period that we passed is fully filled by stress, different emotions general social insecurity, and expressions often unaccepted by the public and citizens in general. It is therefore understandable daily media rhetoric's, that every sentence and information news begin and end with the expression of danger to human security and its operation, without dedicated special attention to the way of public communication and caring expressions, unsolved to the detriment of rhetoric and manner of communication. Nonbiased on the accepted rules of contemporary rhetoric and elementary expressions of ethics of the communications with basic public as well as among citizens unrecognized relations, creates reports on ethical relations and communication in society, as in political, cultural, educational as well as professional ethics.

This phenomenon, as familiar and homely in obedience, just as unknown to human and the etiology of the problem, the definition of rights expressions good behavior and acceptable ethics oratory begins from the moment of non-compliance with a code of human decency, whether civic or institutional.

Key words: the public, media, rhetoric's, sentence and information, accepted rules of contemporary rhetoric, communication in society, as familiar and homely in obedience, manner of communication etc.

¹ Xhemile Selmani Mr.asc e shkencave politike.

1. Kuptimi i etikës oratorike dhe komunikologjisë

Etika e oratorisë dhe komunikologjisë, na mundëson që në mënyrë kritike ta vlerësojmë situatën e dhënë dhe kështu ta krijojmë mundësinë për interpretim dhe veprim me shprehje praktike të drejtë dhe me mirësjellje e standarde të pranuar për mirëdëgjimin e një oratorie të pranueshme nga të gjithë dhe pa pasoja të shprehjeve nxitëse ose devijimeve tjera me ndikim negativ në perceptimin e dëgjueshmërisë mediale dhe komunikative në përgjithësi. Nga kjo që thamë mund të konstatojmë se retorika dhe komunikologjia na mësojnë për vlerat, mirësjellje, respekt në jetë dhe paraqitje të dalluar oratorike në qenësimin e vlerave etiko-retorike, si në oratorinë e të shprehurit ashtu edhe në botëkuptimin e përshkrimit dhe interpretimit të së bukurës dhe artin e të shprehurit për njeriun dhe personalitetin, të dallohet për nga njohuria e të folurit dhe oratorisë së veçantë në vlerësimin e temave të caktuara dhe interpretimin e tyre në publik dhe media *elektronike dhe të shkruara*.

Në cilindo art ekzistojnë vetëm disa rregulla dhe shumë punë praktike, në të gjitha teoritë e akteve të retorikës dhe ligjërimit preket një anë tjetër e rëndësishme të thënies së planifikuar e të sistemuar të shkathtësive individuale që janë të lindura dhe fitohen në bazë të shkollimit. Studimi dhe objekti i lëndës së oratorisë, i shqyrton parimet themelore të të folurit të suksesshëm, si edhe mundësinë që ato parime të praktikohen në praktikën e të folurit si veprim dhe të shprehurit si art, në raport me gojëtarin dhe dëgjuesit e tij.²

Gjuha, fjala e shkruar, si kurrë ndonjëherë më parë, është shndërruar në një mjet të fuqishëm për të ndikuar e drejtuar proceset e mëdha qofshin politike ekonomike, ose të tjera. Secili prej nesh ka në të vërtetë një filozofi bazë të jetës dhe shpirtit emocional, që nëpërmjet të konceptit bazë të të folurit, e cila në praktikë dhe në jetën e përditshme i jep vijueshmëri dhe drejtim mendimit dhe veprimit të çdo njeriu. Nga ky këndvështrim lind pyetje çfarë është retorika cili është definicioni i saj?

Definicioni *definition*- Me retorikë nënkuptojmë gojëtarinë njerëzore si në teori ashtu edhe në praktikë, tek të gjitha rastet publike

² Po të mbështetemi në historinë romake të retorikës do të konstatojmë se retorika ka qenë e trajtuar me një përkujdesje dhe rëndësi të veçantë, por mund të thuhet lirisht se kjo ka qenë periudha kryesore e retorikës e cila është pasuruar dhe mbuluar me shumë terminë ndihmëse shkencore ku edhe sot e kësaj dite shkenca e retorikës mbështetet në ato të dhëna dhe legjenda të veçanta historike për retorikën, prandaj edhe ne për të

dhe private, të paraqitura në formë gojore, të shkruara ose të shprehura nëpërmjet mediave elektronike dhe teknike. Në mbështetje të lëndës së retorikës dhe qëllimit tonë të përbashkët si njerëz të rritur dhe me përgjegjësi të kësaj shoqërie njerëzore, ku jeta ka dyshime dhe dykuptimësi që duhen mësuar sqaruar dhe gojëtaruar, për sfera të ndryshme jetësore dhe për të arritur qëllimin kryesor për rrugën më të shpejtë dhe më të thjeshtë.

Të gjitha realizimet përkatëse gojëtarohen nga gjuha retorike, e cila ka të bëjë me aftësinë për të shpikur dhe për të përdorur shenja në mënyrë të qëllimshme, që nënkupton thelbin e gjuhës e cila konsiston në vendosjen e një korrespondence një ideje dhe një simbol e cila është cilësi themelore vetëm e njeriut dhe gojëtarit në përgjithësi. Këto vështirësi nëpërmjet të lëndës dhe mësimit të gojëtarisë do të kemi mundësinë që të përgatiten për fjalime të suksesshme dhe të veçanta në të gjitha aspektet e mundshme, qoftë e karakterit për fjalime politike, për fjalime ekonomike, për fjalime kulturore, për fjalime sociale, për menaxheriale, rrugë e cila mund të japë rezultate të shpejta dhe të shkëlqyeshme për të zhvilluar mjeshtrinë e oratorisë dhe si të fitohet dëgjuesi dhe publiku.³

Retorika si disiplinë shkencore dhe Hermeneutikerhetorica docens-Që nga kohërat Antike merhëtoriké-greq. oder-rhetorica lat.nuk nënkupton vetëm artin gojor të fjalimit të thënë, por edhe të gjitha llojet e prozave artistike, letrare, përshkrimet e udhëtimeve, bisedave mësimore dhe atyre historiografike, të gjitha këto trajtohen si paraqitje retorike, të cilat sipas të njëjtës metodë janë paraqitje, të nënshtruara të njëjtës rregulle dhe nga këto kërkohet një njohuri e pasur *iudiciume* cila fitohet nga natyra dhe mësohet në baza shkollore. Parë në këtë prizëm, retorika është art i të folurit që ka për qëllim të bëjë njerëzit të dëgjojnë, të kuptojnë dhe të angazhohen në çështje apo tema të caktuara.

Retorika si disiplinë shkencore dhe Hermeneutike *rhetorica docens*. Merret me analizimin dhe interpretimin gjuhësor të komunikimeve analoge të orientuara për ndikim, pra, të adresuara për të bindur *persuasive Kommunikation*, për të plotësuar kërkesat estetike dhe për të argumentuar formën e paraqitjes. Nga kjo nënkuptojmë se jo vetëm

qenë më të kapshëm për lexuesit dhe studentët veçojmë strategjinë e dy folësve romak që i kishte përzgjedhur Shekspiri.

³ Bashkim Dr. Selmani "Retorika dhe komunikologjia" f. 14-18. Universiteti i parë privat "Fon"-Shkup, 2009

llojet e literaturave të ndryshme, por edhe nga artet tjera ndikohet në retorikë si në pikëpamje të aktrimit, ashtu dhe atë të shkencave ndihmëse dhe teorive tjera shkencore etike e estetike që i vënë nën influencë.⁴

2. Juristi si vendimtar dhe argumentues

Zgjidhja e çështjeve juridike është një punë që bëhet çdo ditë nga juristët, gjykatat, prokurorët, avokatët, praktikantët etj. Po t'i pyesim këta njerëz për hollësi profesionale shpesh mund të marrim edhe përgjigje të këtilla; Nuk do të shkojnë shumë larg, por, do të na përgjigjen duke u mbrojtur e duke u shfajësuar se gjuha e profesionistëve është e pakuptueshme për ata që nuk marrin vesh nga profesioni. Ky shfajësim mund të mbulojë, me gjoja respekt, një tërheqje tjetër të turpshme, vështirë se kjo do të qetësonte brejtjet e kuriozitetit dhe të ndërjegjes. Në çastet kur njeriu analizon vetveten, kur nuk ekziston më nevoja për të hequr qafe, gjoja me zgjuarsi, bashkëbiseduesin e huaj, atëherë lind problemi i vështirë, i cili të shtynë të gjesh një zgjidhje. Puna e juristit si dhe të tjerëve që merren me këtë veprimtari, veçanërisht gjithmonë në një pikë të caktuar ka një qëllim kryesor kryesor në të cilin angazhohet e ky është *vendimi* në një proces të zgjidhur.

Parë në këtë prizëm, që të sillet një vendim i drejtë bëhet një angazhim juridik maksimal. Gjyqtari sjell vendimet të cilat ai me shkaqet esenciale duhet t'i kuptojë. Avokati duhet të proklamojë që e drejta duhet të vendoset sipas ligjit për lëndën në fjalë. Prokurori po ashtu si mbrojtës i aktakuzës argumenton në mbështetje të provave dhe padinë e bënë me paraqitjen e bënë në mbështetje të dispozitave ligjore dhe kushtetuese, dhe atë lëndë e zgjidh deri në fund ku e mbron para organeve përkatëse gjyqësore. Tek këshillimi juridik avokati e njofton klientin për alternativat e mundshme përcaktuese dhe vendimmarrëse. Juristi në rolin e tij profesional vlerësohet në këndin e vështrimit të aftësive të tija personale të mbështetura (bazuara) në aftësitë e tij retorike.⁵

⁴ Për shembull për muzikën dhe artin figurativ (vizatimin) po ashtu për arkitekturë etj. (A.v. Knigge), ai që di edhe me mimikë të shpreh qëndrimin e tij tregon, sikurse dramaturgjia me rekuizitat në teatër dhe artistët.

⁵ Retorika është art i të folurit që ka për qëllim të bëjë njerëzit të dëgjojnë, të kuptojnë dhe të angazhohen në çështje apo tema të caktuara. Retorika i ka bazat në antikë, në pikëpamjet e qytetarëve grekë dhe romakë mbi çështje dhe debate të ndryshme publike. Vet fjala retorikë rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë 'të flasësh' apo mund të përkthehet edhe si arti i të folurit.

Parë në këtë prizëm mund të konstatojmë se; rol kryesor në mënyrën e zbatimit të ligjit dhe sjelljes së aktvendimeve dhe aktgjykimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në interpretimin e tyre rol kryesor për natyrën juridike ka shkenca retorikës. Nga kjo që thamë më lartë dhe për të dëshmuar mendimin shkencor për peshën e rëndësisë së lëndës së retorikës, flet vet mënyra e shprehjes se në angazhimin e dhjetëvjeçarit të fundit të studentëve-juristëve që retorika është e paraparë në planprogramet e fakulteteve juridike dhe fakulteteve të shkencave politike të retorika të mësohet si lëndë e detyrueshme dhe zgjedhore për disa fakultete.⁶

3. Çfarë quhet *retorikë juridike*

Për të eliminuar keqkuptimet dhe dilemat përkatëse të retorikës juridike, gjithmonë duhet parë në këtë vështrim; definicioni i retorikës juridike nuk ka një definicion striktë, por ekziston një definicion i thjesht praktikë që është i pranuar me dashamirësi nga të gjithë dhe ne mund ta përcaktojmë në disa pikëpamje të veçanta si; **retorika si teknikë** (çfarë bëjë unë kur zgjidh çështje), **retorika** (cilat burime të informacionit kërkoj si udhërrëfim për t'i interpretuar në interes të mirëqenies shoqërore, që në gojëtarinë time të dallohet e ndërgjegjshmja nga e nëndërgjegjshmja, kur bëhet fjalë për gjyqtarët kanë vijueshmëri në veten e tyre dhe ndryshimin me të tjerët, me palët ose publikun në rast shpalljeje të një aktgjykimi ose aktvendimi), **mjetet e retorikës**: logos, ethos, pathos (në ç' masë ato duhet të çojnë te rezultati), **qëllimi i retorikës** (në qoftë se një precedent është i zbatueshëm, kur mund të heq dorë nga zbatimi i tij me shprehje të veçanta?) **thellimi juridik** (pasi që kemi përzgjedhur çështjen juridike dhe e kemi përpunuar atë po ashtu duke e "provuar se atë se e kemi zgjedhur në mënyrë të drejtë dhe të qëlluar mirëpo, përgatitja ende nuk është përfundimtare për shpallje të një vendimi), **bashkëjetesa juridike** (duhet të bashkëjetoni me të gjitha detajet dhe kuptimet e thella të vendimit për ta bërë publike, gjithmonë këtu duhet pasur vetëbesim në atë vendim që është përzgjedhur, për ta arritur atë përfundimtare dhe shpalljen e vendimit, të jetë i pranuar nga të tjerët me një mjeshtri retorike të dalluar.

Shikuar në këtë prizëm, mund të konstatojmë se juristi ka përfutuar njëmendim të caktuar juridik dhe publik me një sens të veçantë

⁶ Bashkim Dr.Selmani *Retorika dhe arti i të folurit publik* f.38-42. Konspekt ligjëratah në Universitetin Shtetëror të Tetovës- studime posdiplomike Tetovë, 2014.

individual që do të dallonte nga të tjerët nga karakteristikat e lartpërmendura juridike-retorike.

4. Retorika dhe natyra e ligjit

Një nga problemet më të vjetra në filozofinë e ligjit, dhe problemi me të cilin fillojnë zakonisht shumica e kurseve të leksioneve të filozofisë ligjore, është analiza e konceptit të vetë ligjit dhe interpretimi i tij. Parë në këtë prizëm dhe në dioptrinë e retorikës, do të veçojmë disa kuptime të ligjit se si gjykatësit duhet të interpretojnë ose gojëtarojnë ligjin për realizimin e kontrollit shoqëror i cili shërben si një mjet për t'i bërë njerëzit që të bëjnë ca gjëra, të cilat do të kishte pak të ngjarë t'i bënin po t'ua lije atyre në dorë.

Por, ku ndryshon një metodë ligjore e kontrollit shoqëror nga metodat e tjera të kontrollit shoqëror, me të cilat metoda ligjore mund të ngatërrohet me lehtësi si për shembull, fjala vjen, morali, etika, deontologjia, ose thjeshtë dhuna. Nga kjo që thamë mund të konstatojmë se pikërisht roli i retorikës dhe pozita e interpretimit të oratorisë ligjore gjithmonë ka parasysh se “Ligji thotë gjykatësi i vrenjtur në fytyrë, tek gojëtaron ose flet rreptë e shkoqur, me hije të rëndë, Ligji, pra, është siç ju thash dhe që parë, Ligji, domethënë, siç e dini dhe vet, Është, që t’jua shkoqis dhe njëherë, shkurt fjala; Ligj është Ligji.”⁷

Parë në këtë prizëm mund të konstatojmë se Ligji dhe retorika e përcjelljes ligjore gjithmonë janë në kurs të përbashkët dhe veprojnë pandarë, gjithmonë për të bindur njerëzit që t'i bëjnë ca gjëra dhe veprime të detyruara në kuadër të ligjit dhe dispozitave ligjore dhe për një veprim të tillë gjithmonë retorika e bënë më të pranishëm dhe më bindshëm ligjin tek qytetarët në përgjithësi duke pasur gjithmonë pasojat e mos respektimit të aspekteve dhe procedurave ligjore.

5. Metoda e kuptimit retorikë

Shkaku dhe qëllimi i retorikës në përgjithësi është: “një ose më shumë personave të përfitojnë për një mendim të caktuar. Po të zërthehet në gjuhën juridike nënkupton që me rastin e përdorimit të këtillë tek juristët shprehet nocioni i veçantë retorikë ku thuhet “të fitohet e drejta”, “do të ngadhënjej drejtësi”, “do ta dëshmojë pafajësinë” etj. Retori juridik dhe gjuha e shprehjes së tij e di se ku do të dal dhe adresa duhet t'i dedikohet atij që nënkuptohet. Interakcioni në mes të retorit

⁷ W.H.Auden nga “Law Like Love” (“Ligji si Dashuria”).

dhe të adresuarit është një model i paraqitur në gjashtë elemente si poshtë vijojnë:

6. Rruga në kuptim: *Subsuntion*

Retorika zhvillohet me një ndërlidhje së paku në mes të dy aktorëve retorik dhe në anën tjetër të Adresuarit të tij. Retori dëshiron t'i afrohet të Adresuarit, theksoni vetëm një argument të vetëm, me përdorimin e mostrës, citimin, krahasimin, theksimin e të dhënave statistikore. Nga kjo që thamë mund të elaborojmë me një shembull konkret, të një buri i cili i ishte drejtuar gjykatës për shkurorëzim edhe pse në kërkesë kishte pranuar se; gruan e kishte të bukur, amvise të mrekullueshme dhe nënë për t'u marrë shembull, në këto momente gjyqtari pyeti pse atëherë dëshironi të ndaheni, sepse ajo vazhdimisht flet, i përgjigjet burri, pa sqaruar se për çka flet dhe po aty qëndron problemi, pasoi përgjigja, kur nuk më thotë për çka e ka fjalën. Ky pra është problemi në shumicën e rasteve jo vetëm tek gojëtarët por edhe shumë qytetarë të tjerë kur nuk janë bindës në atë çfarë thonë dhe kërkojnë, prandaj edhe ka hapësirë për të nxitur të adresuarin në veprim. Aq sa njeriu e zhvillon aftësinë dhe shkathtësinë e të folurit në qartësinë e mendimeve aq jemi më afër rrugës në kuptim të ndërsjellë.

7. Prej veprimit logjik tek modeli retorik

Susuntioni është i definuar në mënyrë të përgjithshme, për shembull; "Urdhërimet e Zotit nuk thyhen, d.m.th. pikëpamja logjike nënkupton se urdhërimet e Zotit nuk duhen thyer është ndërlidhja e quajtur *Syllogismus*. Në një nga faqet e leksioneve të tij për shembull mbi pragmatizimin e Ulliam Xhejmsi na kujton, se secili prej nesh ka në të vërtetë një filozofi bazë të jetës, madje edhe ata, të cilët emrat dhe konceptet e filozofisë nuk i njohin ose i quajnë anateme. Brenda secilit prej nesh ekziston një prirje, qoftë retorike apo diç tjetër, mund ta quajmë edhe filozofi ose jo, e cila i jep vijueshmëri dhe drejtim mendimit dhe veprimit, ndërsa retorika i jep pamje dhe kuptim për dëgjuesin dhe publikun.⁸Nga kjo që thamë më lartë mund të konstatojmë se kjo është rruga nga veprimit logjik tek modeli retorik për atë që i japim përgjigje nga drejtimi, mendimi dhe veprimi.

⁸Retorika juridike nënkupton se si me një fjalim mundemi për një të mirë të bindim të tjerët.

8. Vetitë kundërshtuese: (Tezat-Primusi)

Retori dhe i Adresuari punojnë në një lëndë së bashku. Në një moment lindin mendime të ndryshme, secili dëshiron që të dominojë mendimi i tij. Çfarë e bëjnë retorinë të arrijë deri tek ngadhënjimi i mendimit të tij:

a). teza: e tërë çfarë atë mendim e bën dominues,

b). prej cilëve faktorë është e varur teza, (si për shembull, pikënisje duhet të jetë interesi i përgjithshëm, interesat e njerëzimit duhet t'i veçojë në tezë, teza duhet të posedojë veçanërisht argumentimin, teza duhet të vërtetojë se a i plotëson të gjitha kushtet d.m.th. kalimin nga teza në premisë (deduksion regresiv) ose progresiv e dedikuar nga premisa tek teza. Ndërlidhja në mes tezës dhe premisë nuk ekziston që në fillim, retorik duhet ta prezantojë dhe të njoftojë se si vjen deri tek kjo ndërlidhje sipas strategjisë së tij. Premisa: e tëra çfarë qëndron në kuptim retorik e parashtron dhe i adresuari e pranon. Shkaku i suksesit të retorik është Primasi të cilin i adresuari e pranon.

9. Procedura Subsumcion

Retorika mëson për një mendim strikt. Strategjia kërkon një ndërlidhje me mendimin adekuat (Premis) cili model do të aplikohet për të arritur tek qëndrimi i paraparë me anën e retorikës të subsumcionit. **Silogjizmi juridik dhe çfarë i paraprinë atij.** Kemi nga dy thënie (p/t) njëri është Premisi (p) dhe tjetri është teza (t), më pas është e nevojshme thënia (m). (t)subsumtivi ndaj (p) heton. Nga burimi prej të cilit (p) njëherë me titull (t) vërteton ndërlidhjen me thënien m–vjen në përfundim nga dy thënie (p/m) të dytën (m) si hulumtuese për përdorim, kështu që veçohet thënia e tretë (t) si pasojë përfundimtare (nga p). E barabartë me domethënien: një (t) gjendet në subsumtiv, është nga thënia (p) e vërtetuar si vijon, ajo në përfundim nga thënia (t!) Më e kuptueshme do të jetë nga shembulli në vijim:

- p : kush ka qëlluar me thikë duhet të dënohet,
- m: individi i ka qëlluar,
- t! : individiduhet të dënohet,

Këtë veprim e quajmë syllogizmus juridik. Teza vijon e qëlluar: “A është e drejtë që individi i të dënohet“ për këtë përgjigjen e formulon thënia m: “t është e vlefshme, derisa individi i ka qëlluar me thikë.

10. Vetitë përmbajtëse dhe formale të subsumcionit

Puna e subsumimit ka në vete vetinë formale dhe përmbajtjen. Vetia formale është struktura e një argumentimi, thoni vetëm një argument të vetëm për nxitje të mëtutjeshme, veprim i cili nënkupton parapërgatitja për një rezervë të të dhënave e cila do të ketë veti përmbajtëse dhe formale të subsumcionit. Shumë më lehtë është për të mbajtur një ligjërim, i cili fluturimthi i prekë temën kryesore, se sa atë ta këndellës në fakte. Sepse një ligjërim i tillë nuk do të lë mbresa për t'i fiksuar dëgjuesi dhe publiku, vetitë përmbajtëse dhe formale të subsumcionit nënkuptojnë që edhe ju mund të përgatitni një argumentim të të dhënave se sa të flisni gjatë kohë por, me fjalë jobindëse (boshe) për publikun, argumentimi nënkupton që një parapërgatitje duhet bërë më herët ose dy dytë para fjalimit. Nëse mjaft herët keni vendosur argumentin me të dhëna bindëse atëherë keni vendosur për temën, dhe ndërdija individuale punon për ju.⁹

11. Vetitë receptive dhe produktive të subsumcionit

Atë çfarë nuk e ka i Adresuari për t'i dhënë retorit duhet retorin ta krijojë, si përfundim për ta lë të adresuarin për ta gjetur vetë, e ai pikërisht është sinqeriteti me të cilin njeriu flet, dhe i jep zërit një ngjyrë të së vërtetës, të cilin asnjë mashtrues nuk mund ta emitojë. E drejta e përgjithshme nuk vepron nëse retorin nuk ka veti receptive, nuk vepron sipas të vërtetave të paracaktuara të vlefshmërisë universale dhe të paepshme, për të arritur në përfundime që nxirren prej vetive receptive dhe produktive të subsumcionit. Metoda e këtille është induktive dhe ajo mënyrë i nxjerrë përgjithësimet e veta nga e veçanta e mënyrë së komunikimit në relacion retor, dëgjues dhe publiku.

Në përpjekje për t'i dhënë kuptimit të gojëtarisë një shprehje të artikuluar në rregulla dhe në parime, prandaj retorin në këto momente të veçanta me hipotezat e gojëtarisë është i vënë e rivënë në provë gjithnjë nga dëgjuesit dhe publiku me vetitë receptive.¹⁰

⁹ Bashkim Dr. Selmani “Marrëdhëniet publike dhe zhvillimit të tyre në shoqërinë bashkëkohore”, f.19-29 Universiteti Shtetëror i Tetovës Fakultet Juridik- Programi studimor Shkenca Politike Tetovë, 2015.

¹⁰ Bashkim Dr. Selmani “Marrëdhëniet publike dhe zhvillimit të tyre në shoqërinë bashkëkohore”, f.19-29 Universiteti Shtetëror i Tetovës Fakultet Juridik- Programi studimor Shkenca Politike Tetovë, 2015.

Conclusion

Based on the background of the historical development and the opinion of the rhetoric which has its forces in communications as a science, we can conclude that they are all undertakings of man from the internal energy of the progressive movements in the opinion of the interpretation of what is beautiful and accepted for all which directs the force of the human mind with all its products maker engagement.

Understandably, the human mind does not act itself isolated from other components such as the senses, perceptions, good picture, character, will, temperament and overall bio-phycology life and the reason and the end of all that constitutes the totality of man as homo-humanist. Contact action of all the components in context is the result that comes from the unity of opposites in the effort of thinking and eloquence concretized through interpretation. From what we said so far, makes us understand that we must learn from the experience of others to be courageous in that interpretation and say publicly, we cannot say that there is no man of whom it can be said that a It is born orator, for his speech on learning from birth to exceed a certain amount of time to learn speech in the style of oratory. Viewed in this prism, we can conclude that the main role in the way law enforcement and the behavioral decisions and judicial acts and extra-judicial proceedings in their interpretation of the key role on the legal science played legal nature of the rhetoric.

From what we said above and effort to prove scientific thinking about the weight of importance of the subject of rhetoric, speaks the way of expressing that commitment last decade student-lawyers that rhetoric is foreseen in the curricula of faculties of law and political science, where the rhetoric is taught as a compulsory subject and optional for some faculties because the legal practice that the judiciary in the country with little or no disregarded the communication criteria and ethical issues concerning the rights of the parties in a trial and conversely.

Bibliografia

1. Bajram Dr.Kosumi, Zhanret e gazetarisë II [Ligjëratë për studentët e Degës së Gazetarisë të Fakultetit të Filologjisë, UP]
2. Bashkim Dr. Selmani “Marrëdhëniet publike dhe zhvillimit të tyre në shoqërinë bashkëkohore”. Universiteti Shtetëror i Tetovës Fakultet Juridik- Programi studimor Shkencat Politike Tetovë, 2015
3. Bashkim Dr. Selmani “Retorika dhe komunikologjia “- Shkup, 2009
4. Melvin Mencher, Raportimi dhe shkrimi i lajmit, Tiranë 1998.
5. Hamit Boriçi, Gazetaria 2, SHBLU, Tiranë, 2004.
6. Missouri Group, Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, Botimet IDK, 2010 Literatura shtesë:
7. David Randall, Gazetari universal, ISHM, Tiranë, 2003.
8. Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore, redaktuar nga Malcolm F. Mallet (përkthyer nga Ilir Ikonomi), Dituria, Tiranë, 2003.
9. Rexhep Qosja, Apologjia e polemikës, Gojëtaria ose muza e harruar, Intervista e popullarizuar, Reklama dhe vlerat shpirtërore, në librin Anatomia e kulturës, Rilindja, Prishtinë, 1976.
10. Gazetaria Stephan Rusmohl Gazetaria, Tiranë, 2010
11. Bashkim Dr. Selmani “Etika deontologjia dhe Bihevizizmi” Universiteti Parë Privat “FON”-Shkup, 2010 .
12. Joshua S. Goldstein “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”
13. Mehdi J. Hetemi “Disa Tema Aktuale të Ekonomisë së Tregut”.
14. Myrvete Badivuku-Pantina, “Korporatat Multinacionale dhe roli tyre në rendin e ri Botëror”, f. 10
15. Joshua S. Goldstein, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, f. 397-398
16. “E Drejta”, revistë për çështje juridike dhe shoqërore, botues, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2002.
17. Goldstein, S. Joshua. “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, Dituria, Tiranë 2003.
18. Llaci, Shyqyri. “Manaxhimi”, albPAPER, Tiranë 2002
19. Steger B. Manfred. “Globalizimi”, Oxford, Ombra GVG, Tiranë, 2003
20. McLain, Iain. “Fjalor Politik”, Oxford, shtëpia e librit dhe komunikimit, Tiranë 2001